



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 29

Tiranë – E hënë, 25 shtator 2017

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Gjykatës së Rrethit
Gjyqësor Tiranë nr. 6840,
datë 21.7.2017

Me objekt kërkesën për përfundimin e procedurës së falimentimit të
shoqërisë AGC Retail sh.p.k., me NIP: K91519017K, bazuar në
nenet 11, 13, 15, 19(3), 30(1)(b) e vijues, të ligjit nr. 8901/2002, “Për
falimentimin”, të ndryshuar.....

3



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
SEKSIONI TREGTAR**

GJYKATA E FALIMENTIMIT

Nr. akti: 731

Datë regjistrimi: 5 nëntor 2015

Nr. vendimi: 6840

Datë vendimi: 21 korrik 2017

VENDIM

Nr. 6840, datë 21.7.2017

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
SË FALIMENTIMIT - FAZA E DYTË**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

Rezarta Mataj, gjyqtare,

me sekretare gjyqësore Ina Serjanaj, në Tiranë, sot në datën 21 korrik 2017, ora 13:30, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile-tregtare, që i përket:

Kërkues: Shoqëria AGC Retail sh.p.k. me NUIS: K91519017K, me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, km 14, Tiranë, me administrator Elson Bajlozi, e përfaqësuar nga administratorja e falimentimit Mimoza Cara (Memoçi).

Me pjesëmarrjen e debitorit: Shoqëria AGC Retail sh.p.k. me NUIS: K91519017K, me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, km 14, Tiranë, me administrator Elson Bajlozi me prokurë të posaçme nga av. Xharije Nela dhe/ose Alma Zyba, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

Me komitet të kreditorëve:

1. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, Dega Rajonale Tatimore Tiranë, e përfaqësuar nga Sonila Krimçe.

2. Avokatura e Shtetit pranë Ministrisë së Financave Tiranë (në mungesë).

3. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, dega Tiranë, e përfaqësuar nga juriste Rakela Ismailaj.

4. Shoqëria, banka Intesa San Paolo Bank sh.a., me NUIS: J81817006P, me adresë: Tiranë, rruga "Ismail Qemali 27", me administrator Silvio Pedrazzi, i përfaqësuar në gjykim nga juristi Bledi Andoni (në mungesë).

Objekti: Kërkesë për përfundimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë AGC Retail sh.p.k., me NIPT: K91519017K, bazuar në nenet 11, 13, 15, 19(3), 30(1)(b) e vijues të ligjit nr. 8901/2002, "Për falimentimin", të ndryshuar.

- Në bisedimet përfundimtare, administratorja e falimentimit, Mimoza Cara, u shpreh: *"Jam për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë AGC Retail sh.p.k. për mospasje më të masës së falimentimit dhe se shpërndarjet e fundit janë realizuar"*.

- Përfaqësuesit respektivë të Degës së Doganës Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe av. Xharije Nela, përfaqësuese e debitorit, u shprehën: *"Dakord me administratoren"*.

- Gjykata, pasi zhvilloi hetimin gjyqësor, konsultoi çështjen në tërësi në ligj material, procedural, prova dhe formoi bindjen e saj të brendshme,

VËREN SE:

I. Mbi rrethanat dhe faktet e çështjes

1. Shoqëria AGC Retail sh.p.k., e regjistruar në datën 19 mars 2009, me NUIS: K91519017K, me adresë rruga "Llambi Bonata", nr. 19, kati 4, ap. 11, Kombinat, Tiranë, me objekt të veprimtarisë: *"Tregtim tekstile, konfeksione, import-eksportin e tyre, tregtim me pakicë brenda vendit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Shërbim konsulence financiare dhe shërbim konsulence ligjore"*, me status të pezulluar, ka paraqitur kërkesën për çelje të procedurës së falimentimit që në datën 5.11.2015.

2. Gjykata, pasi dëgjoi edhe mendimin e administratorës së përkohshme znj. Mimoza Cara, në fazën e parë të procedurës, e cila u shpreh se asetet e AGC Retail sh.p.k. nuk janë të mjaftueshme as për të mbuluar shpenzimet gjyqësore, vërejti se ishte i gatshëm vetë administratori i shoqërisë, Elson Bajlozi, të parapaguajë shpenzimet e procedurës së falimentimit, duke ngrirë pranë bankës BKT sh.a., shumën prej 1 000 000 lekësh, e në përfundim vendosi pranimin e kërkesës për çeljen e falimentimit për të.

3. Me vendimin e datës 18.5.2016, Gjykata e Falimentimit vendosi: *"Pranimin e kërkesës si e mbështetur në ligj dhe në prova"*.



Të deklarojë sot, në datën **18 maj 2016, ora 12:00**, të hapur, procedurën e falimentimit për shkak të paaftësisë paguese ndaj debitorit, shoqërisë **AGC Retail sh.p.k.**, me NUIS: K91519017K, me administrator Elson Bajlozin, me seli në rrugën “Llambi Bonata”, kati 19/4/11, Kombinat, Tiranë, Shqipëri.

Emërimin si administratore të falimentimit, për shoqërinë AGC Retail sh.p.k., të znj. **Mimoza Cara**, me adresë: Pallati i Kulturës, kati i tretë, Tiranë, me NUIS: K31414020T dhe celular: 00355692091209.

Të gjithë kreditorët e shoqërisë AGC Retail sh.p.k., të paraqesin pranë administratores së falimentimit deri në datën **27 korrik 2016**, pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë AGC Retail sh.p.k., t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratores së falimentimit.

Mbledhja e kreditorëve për raportim të mbahet në datën **27 korrik 2016**, në katin e tretë, salla nr. 4 e GJRRGJ-së Tiranë, në orën 14:00.

Mbledhja për verifikim të pretendimeve të kreditorëve mbahet brenda 27 shtatorit 2016.

Ky vendim u komunikohet kreditorëve: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria Vendore e Doganave Tiranë, City Park sh.a., si dhe Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Tiranë, si përfaqësuese të subjekteve shtetërore.

Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë AGC Retail sh.p.k. dhe bërjen e veprimeve në regjistrat përkatës:

Buletinin e Njoftimeve Publike të Qendrës së Botimeve Zyrtare;

Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikimin e saj në faqen e saj elektronike;

Dhomës Kombëtare të Noterëve;

Regjistrat të Barrëve Siguruese;

Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të njoftuar zyrat vendore.

T’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve financiare jobankare të licencuara në Republikën e Shqipërisë:

Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe publikimin e saj në faqen zyrtare elektronike;

Autoritetit Rrugor Kombëtar pranë Ministrisë së Transporteve.

Në faqen zyrtare elektronike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Publikimin e dispozitivit të vendimit në gazetën “Shqip” dhe në gazetën “Panorama”, dy herë radhazi në faqen e parë ose në një gazetë tjetër të së njëjtës natyrë që administratorja e konsideron të përshtatshme.

Ky vendim është menjëherë i ekzekutueshëm.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes, ndërsa për personat e tretë në mungesë, ky afat fillon nga dita e njoftimit.

4. Në datën 27 korrik 2016 është realizuar mbledhja e raportimit nga ana e administratores së falimentimit, ku sugjeroi vazhdimin e procedurës së likuidimit të AGC Retail sh.p.k., pasi nuk ka mundësi riorganizimi. Po ashtu, në këtë mbledhje gjykata e falimentimit vendosi:

- Të caktojë, bazuar në nenin 53, të ligjit 8901/2008, komitetin e kreditorëve me tre anëtarë në përbërje: Dega e Doganës Tiranë, si përfaqësuese e kreditorëve të pretendimeve të mëdha; banka Intesa San Paolo, si përfaqësuese e kreditorëve të shumave të vogla, si dhe City Park sh.p.k.; si një nga kreditorët më të mëdhenj, meqenëse nuk ka kreditorë të tjerë të siguar apo përfaqësues të punëmarrësve. Më pas, në vend të City Park sh.p.k. u zëvendësua me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, meqenëse City Park sh.p.k. nuk fitoi cilësinë e kreditorit, pasi nuk paraqiti pretendime.

- Bazuar në nenin 124, të ligjit 8901, të vitit 2008, vendos mbledhjen e dytë për rakordim të administratores Mimoza Cara, pasi të azhurnohet raporti mbi pasuritë e debitorit, sipas praktikës së zhdoganimit që Dega e Doganave Tiranë, për mobilieritë e blera para momentit të hapjes së procedurës së falimentimit.

- Gjithashtu, është kërkuar informacion nga ZVRPP-të e tjera të Republikës që nuk kanë kthyer informacion, Regjistrat të Barrëve Siguruese, nëse ka ndonjë pasuri etj.

5. Pas publikimit të këtij vendimi dhe korrespondencës së Gjykatës me zyrën qendrore të pasurive të paluajtshme dhe atyre vendore, kanë kthyer përgjigje negative se në emër të AGC Retail sh.p.k., nuk ka asnjë pasuri të paluajtshme të regjistruar.

6. Nga ana e Regjistrat të Barrëve Siguruese, Gjykata vihet në dijeni se janë tri regjistrime për barrë siguruese në favor të barrëmarrësit Raiffeisen Bank sh.a. të regjistruar në datën 17.11.2011, 25.11.2011 dhe 16.11.2012, për një kohëzgjatje 25-vjeçare.



7. Nga ana e Degës së Doganave Tiranë dhe Degës Rajonale Tatimore, rezultuan detyrime të pashlyera nga ana e AGC Retail sh.p.k.

7.1 Po ashtu, rezulton se AGC Retail ka disa mobilie të zhdoganuara dhe të papaguara detyrimet nga ana e saj, por që pretendohet se për shkak të një urdhri ekzekutimi dhe mosshlyerjeje të detyrimeve të qirasë, City Park sh.p.k. ka sekuestruar mobilet si kundërvleftë e qirasë së papaguar nga AGC Retail sh.p.k. Gjykata, në datën 29.7.2016, ka urdhëruar dorëzimin e këtyre mobileve tek administratorja Mimoza Cara, si pjesë e masës së falimentimit. Mbi këtë kërkesë nuk kishte reagim fillestar.

8. Në mbledhjen e datës 9.9.2016, mbi raportimin, gjykata i dha mundësi administratorës që të azhurnojë aktin e saj në përputhje me kthimpërgjigjet e paraqitura nga institucionet.

9. Në mbledhjen e datës 27.9.2016 u zhvillua mbledhja e verifikimit të pretendimeve të kreditorëve, ku paraqitën pretendime: Dega e Doganës, Roberto Mammarella srl, Intesa San Paolo Bank sh.a., ABI Bank sh.a., Drejtoria Rajonale Tatimore. Me vendimin e datës 11.11.2016, Gjykata e Falimentimit, pasi dëgjoi pretendimet e kreditorëve, pretendimet e njohura a të kundërshtuara të administratorës, miratoi këtë tabelë përfundimtare:

TABELA E PRETENDIMEVE TË KREDITORËVE, TË VERIFIKUARA

Nr.	Kreditori	Shuma e pretendimit (në lekë) Germa "dh" e nenit 605 të KC-së	Shuma e pretendimit (në lekë) Germa "e" e nenit 605 të KC-së	Gjoha (në lekë)	Interesa (në lekë)	Detyrimi total (në lekë)	Pretendime të vërtetuara (në lekë) (neni 145)
1	Dega e Doganës Tiranë	743,788		8,199,738	1,767,251	10,710,777	10,710,777
2	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	648,415		653,906	82,818	1,385,139	1,385,139
3	ABI Bank		12,716	4,345		17,061	17,061
4	Intesa San Paolo Bank		628,312			628,312	628,312
5	TOTALI	1,392,203	641,028	8,857,989	1,850,069	12,741,289	12,741,289

10. Gjykata nuk njohu pretendimet e shoqërisë italiane Arredamenti Mammarella srl, pasi nuk provoi se kishte kredi ndaj AGC Retail sh.p.k.

11. Në datat 29.12.2016, 28.4.2017, 15.6.2017 janë realizuar tri raportime tremujore nga ana e administratorës së falimentimit mbi ecjen e procedurës dhe të akumulimit dhe të shitjes së masës së falimentimit.

12. Në datën 19.1.2017, Gjykata miratoi shpërndarjen e parë të masës së falimentimit, e cila përbëhej nga shpenzime të procedurës së falimentimit, shpërblymi i administratorës së falimentimit dhe anëtarëve të komitetit të kreditorëve, shpërndarje te Komiteti i Kreditorëve, Dega e Doganës Tiranë, në shumën 353,325 lekë dhe Dega Rajonale e Tatimeve Tiranë, në shumën 308,020 lekë.

13. Mbi detyrimin e City Park sh.p.k., kjo e fundit paraqiti një marrëveshje të kryer përpara çeljes së procedurës së falimentimit, datë 2.6.2015, me AGC Retail sh.p.k., ku palët bien dakord se për shlyerjen e një pjese të detyrimit prej 316,241.2 eurosh, mobilet e ndodhura te dyqanet Diesel, Para, Segue, Melo e Grano, Miss Sixty, Murphy, në pronësi të AGC Retail sh.p.k., i dorëzohen City Park sh.p.k.

14. Në raportimin e datës 15.6.2017, administratorja e falimentimit i sugjeroi gjykatës bashkë me dy anëtarët e komitetit të kreditorëve (2/3 e anëtarëve) mbylljen e procesit të falimentimit të AGC Retail sh.p.k., pasi nuk ka më masë për likuidim.

15. Në datën 12.7.2017 u mbajt mbledhja e llogarive të fundit dhe shpërndarjes së fundit të masës së falimentimit, ku Dega e Doganës përfitoi 21,821 lekë dhe Dega Rajonale e



Tatimeve, në shumën 19,300 lekë dhe u vendos që në datën 21 korrik 2017 të realizohet mbledhja e mbylljes së procedurës së falimentimit. Në këtë datë, të gjithë të pranishmit: administratorja, debitori, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë dhe Dega e Doganës Tiranë sh.a. ishin për mbylljen e procedurës së falimentimit të AGC Retail sh.p.k. Administratorja dorëzoi edhe të gjitha dokumentet financiare, arkivin e saj, i cili ka shërbyer gjatë procedurës së falimentimit.

II. Legjislacioni i zbatueshëm

16. Ligji nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar

Neni 159 - Shpërndarja e fundit

“1. Shpërndarja e fundit bëhet sapo të përfundojë shitja e masës së falimentimit.

2. Shpërndarja e fundit bëhet vetëm me miratimin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit.”

Neni 160 - Mbledhja përfundimtare

“1. Kur jep pëlqimin për shpërndarjen përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit përcakton edhe afatin për një mbledhje përfundimtare të kreditorëve. Gjatë mbledhjes:

a) diskutohen llogaritë e paraqitura nga administratori i falimentimit;

b) paraqiten vërejtje ndaj listës përfundimtare;

c) vendosin për sendet që janë pjesë e masës së falimentimit dhe të papërshtatshme për shitje.

2. Periudha kohore ndërmjet shpalljes së datës së mbledhjes dhe mbledhjes nuk mund të jetë më pak se tri javë dhe jo më shumë se një muaj.

3. Për vendimet e gjykatës për vërejtjet e një kreditori zbatohen, sipas rastit, parashikimet e pikave 2 dhe 3, të nenit 157, të këtij ligji, ligji nr. “Arsyetimi i gjykatës mbi mbylljen e procedurës së falimentimit.”

Neni 163 - Përfundimi i procedurës së falimentimit

“1. Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit.

2. Vendimi dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht.”

III. Analiza e gjykatës mbi çështjen

17. Sipas nenit të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar, gjykata, në fazën e dytë procedurale të falimentimit vlerëson se i ka përmbushur të gjitha etapat që parashikon kjo fazë, pra:

- Ka realizuar mbledhjen e raportimit të administratorës së falimentimit mbi gjendjen e shoqërisë, asetet e saj, debitë/kreditë dhe mundësinë për riorganizim apo likuidim; formoi edhe organin e qeverisjes së shoqërisë në falimentim, komitetin e kreditorëve prej tre anëtarësh.

- Realizoi mbledhjen e verifikimit të pretendimeve të kreditorëve të AGC Retail sh.p.k., masën e tyre dhe pretendime për radhën.

- Dëgjoi administratoren e falimentimit dhe hartoi tabelën përfundimtare të pretendimeve të kreditorëve, të cilat nuk mund të ndryshohen, pasi përbën vendim të formës së prerë dhe titull ekzekutiv.

- Miratoi shpërndarjen e parë të masës së falimentimit dhe shpërndarjen e fundit të masës së falimentimit të kreditorët: Drejtoria Rajonale Tatimore dhe Drejtoria e Doganave, dega Tiranë.

- Në fund, miratoi mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë AGC Retail sh.p.k., meqenëse nuk ka më masë falimentimi dhe se nuk ka as mundësi për të rritur këtë masë me vjelje të debitorët, pasi këto nuk ekzistojnë.

17.1 Ky vendim nuk i pengon kreditorët të realizojnë ndonjë shpërndarje të vonuar të masës, nëse grumbullohet një e tillë në të ardhmen.

18. Sipas ligjit nr. 9901/2008, neni 99, pika “ç”, parashikon si shkak të prishjes së shoqërisë hapjen e procedurave të falimentimit. Sipas ligjit nr. 9723/2007, “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”, parashikohet se një shoqëri çregjistrohet sapo vendimi gjyqësor të ketë marrë formë të prerë për prishje apo edhe kryesisht nga QKB-ja, nëse me anë të një vendimi gjyqësor, shoqëria është shpallur e falimentuar.

19. Në rastin konkret, duke qenë se gjykata vendos mbylljen e procedurës së falimentimit, për shkak se mbaroi masa e falimentimit, gjykata urdhëron edhe QKB-në, që, në përputhje me ligjin e tyre organik, të çregjistrojnë edhe shoqërinë nga regjistrat e saj. Po ashtu, ky vendim do t’u dërgohet të gjitha drejtorive rajonale tatimore, doganore etj., për t’i hequr nga regjistri si subjekte.

20. Si përfundim, gjykata vendos mbylljen e procedurës së falimentimit, prishjen e shoqërisë AGC Retail sh.p.k. për shkak të paafetësisë paguese dhe mospasjes më masë falimentimi për të shpërndarë të kreditorët e radhës.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 159, 160, 163, 166, të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të hapur, në datën 18 maj 2016, ndaj shoqërisë AGC Retail sh.p.k. me NUIS: K91519017K, me administrator Elson Bajlozin, me administratore falimentimi znj. Mimoza Memoçi (Cara), me seli në rrugën “Llambi Bonata”, kati 19/4/11, Kombinat, Tiranë, Shqipëri, për shkak të shpërndarjeve të masës së falimentimit të grumbulluar dhe mospasjes më, të mëtejshme, masë falimentimi.

2. Çregjistrimin e shoqërisë AGC Retail sh.p.k. nga regjistri tregtar i shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe organeve të tjera tatimore, doganore etj.

3. Mbyllja e procedurës së falimentimit nuk pengon kryerjen e shpërndarjes së vonuar.

4. Ky vendim u komunikohet kreditorëve: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria Vendore e Doganave Tiranë, Intesa San Paolo Bank sh.a., si dhe Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Tiranë, si përfaqësuese e subjekteve shtetërore.

5. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të shoqërisë AGC Retail sh.p.k. dhe bërjen e veprimeve në regjistrat përkatës dhe publikimin e saj në faqen e saj elektronike përkatëse, në:

a) Buletin e Njoftimeve Publike të Qendrës së Botimeve Zyrtare;

b) Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

c) Dhomës Kombëtare të Noterëve;

d) Regjistrin të Barrëve Siguruese;

e) Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të njoftuar zyrat vendore;

f) Bankat e nivelit të dytë dhe institucioneve financiare jobankare të licencuara në Republikën e Shqipërisë;

g) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

h) Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

i) Autoritetit Rrugor Kombëtar pranë Ministrisë së Transporteve.

j) Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

6. Një kopje e vendimit dhe aktet e tërë dosjes së falimentimit (faza e parë dhe e dytë) të shoqërisë së falimentuar AGC Retail sh.p.k. i dërgohet edhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të verifikuar nëse ka veprime/mosveprime që përbëjnë vepra penale në fushën e shoqërive tregtare dhe të falimentimit për shoqërinë AGC Retail sh.p.k.

7. Publikimin e dispozitivit të vendimit në gazetën “Shqip” dhe në gazetën “Panorama”, dy herë radhazi, në faqen e parë ose në një gazetë tjetër të së njëjtës natyrë që administratorja e konsideron të përshtatshme.

8. Shpenzimet gjyqësore mbeten siç janë bërë.

9. Bashkëlidhur dosjes gjyqësore inventarizohet edhe dokumentacioni i përdorur nga administratorja e falimentimit të shoqërisë AGC Retail sh.p.k.

10. Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e sotme e shpalljes së këtij vendimi. Për palët e tjera të papranishme ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot, në datën 21 korrik 2017, ora 13:58.

Sekretare gjyqësore

Ina Serjanaj

Gjyqtare

Dr. Rezarta Mataj

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2017